



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:067867

Datë: 13.01.2021

Numri i dokumentit: 01404231

C.nr.530/2020

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore e përbërë nga Gjyqtari Individual Naim Mehulli, në çështjen juridike të paditëses Sh.V nga Mitrovica, të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. F.Sh nga Mitrovica, kundër te paditurës K... Mitrovicë, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokati Publik Komunal A.M, për shkak të kompensimit të ardhurave në emër të shpërblimit jubilar, pas mbajtjes së seancës kryesore publike, me dt. 13.01.2021 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. OBLIGOHET e paditura K... Mitrovicë, t'ia paguajë në emër të pagesës për shpërblim jubilar si e punësuar te e paditura, paditëses: Sh.V, për 20 vite të përvojës së punës në vlerë të dy (2) pagave në emër të shpërblimit jubilar, shumën prej 923.24 €, (nëntëqind e njëzetë e tre euro e njëzet e katër cent), të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

II. OBLIGOHET e paditura K... Mitrovicë, t'ia paguajnë paditëses shpenzimet e procedurës në shumë totale prej 259 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja me datën 12.06.2020 ka ushtruar padi e të precizuar për kompensimin e te ardhurave personale në emër të shpërblimit jubilar për (2) dy paga duke u bazuar në nenin 17 par. 3 nënpar.3.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të miratuar në muajin Qershor 2018.

Gjykata, me dt.12.01.2020, ka caktuar seancë për shqyrtim kryesor, në të cilën ka prezantuar i autorizuari i paditëses dhe përfaqësuesi i të paditurës.

I autorizuari i paditëses në seancë dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe e njehta të aprovet në tërësi si e bazuar. Gjykatës i'a dorëzoi pasqyrën e llogarisë bankare të paditëses ku shihet se paditësja pagën mesatare e ka përfaqësuar sikurse në kërkesëpadi e të cilën e kam kërkuar sipas listës së pagës lëshuar nga Buxheti i Kosovës, mirëpo se paditësja e ka këtë pagë nuk është kontestuese pasi që kjo vërtetohet edhe nga pasqyra e llogarisë bankare, e ku nga kjo pasqyrë konstatohet se paditësja e

ka pagën mesatare 2 euro më shumë, mirëpo ne kërkojmë sikurse në kërkesëpadi. Shpenzimet e procedurës kontestimore i kërkoj, si dhe hjeku dorë nga llogaritja e kamatës.

Përfaqësuesi i të paditurës në seancë dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se e kundërshtojë padinë dhe kërkesëpadinë, ky kundërshtim vie si pasojë e mjeteve financiare në buxhetin komunal. Nuk është kontestuese që paditësja është punëtore tek e paditura si dhe nuk është kontestuese as vitet e punës dhe lista e të ardhurave personale.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, referuar nenit 7 dhe 8 të LPK-së, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik nxori dhe administroi këto prova: Kërkesa drejtuar të paditurës dt. 26.05.2020; Lista e pagës; Vërtetimi lëshuar nga QKMF "...” Mitrovicë dt.24.02.2020; Kontrata e punës dt. 01.01.2020; Pasqyra e llogarisë bankare lëshuar nga ... dt.11.01.2021; dhe pas shqyrtimit bashkërisht të të gjitha këtyre provave gjykata konstatoi këtë gjendje:

Fillimisht paditësja para ngritjes së padisë ju ka drejtuar të paditurës me kërkesë të dt. 26.05.2020 për kompensimin e pagave jubilarë, të cilën e paditura e ka pranuar po në të njëjtën datë, mirëpo në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi që e njëjta ka kthyer përgjigje në kërkesë. Nuk është kontestues fakti që paditësja është duke punuar edhe tani tek e paditura, ky fakt vërtetohet nga këto prova: Kontrata e Punës e dt.01.01.2020, e lidhur në mes të paditësës dhe të paditurës dhe Vërtetimi i lëshuar nga e paditura me dt. 24.02.2020, e po ashtu këtë fakt nuk e ka kontestuar as e paditura në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare.

Nuk është kontestues fakti se lartësia e pagës bazë që paditësja e ka realizuar nga e paditura është shuma mujore prej 461.62 €, ku kjo vërtetohet nga gjendja e listës së pagave lëshuar nga Ministria e Financave-Buxheti i Republikës së Kosovës, e po ashtu këtë fakt nuk e ka kontestuar as e paditura në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare.

Lidhur me pretendimet e të autorizuarit të të paditurës duke e kontestuar padinë si pasojë e mjeteve buxhetore, pretendimet e lartëcekura gjykata i refuzoj si të pa bazuar, dhe atë duke u bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të miratuar në dt. 11.06.2018, andaj për vendosje sipas pikës I të dispozitivit sa i përket pagesës së (2) dy pagave në emër të shpërblimit jubilar iu referua nenit 17 par 3 nën par.3.2 të kontratës së lartëcekur me të cilën parashihet se "Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy pagave mujore të tij", e në rastin konkret paditësja është e punësuar te e paditura për më shumë se 20 vite, dhe vazhdon më tutje.

Bazuar në nenin 17 par.4 Kontratën Kolektive Sektoriale është detyrim i punëdhënësit të fundit këtu të paditurës që t'i paguaj kompensimin për kategorinë e lartcekur.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditësës për një (1) seancë të mbajtur shumë prej 135 euro, në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104 euro, si dhe 20 euro në emër të taksës për padi.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi në nenin 143 par. 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.530/2020, datë 13.01.2021

Numri i lëndës: 2020:067867
Datë: 13.01.2021
Numri i dokumentit: 01404231

GJYQTARI
Naim Mehulli

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.